



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA  
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE  
SEKTORI I FINANCËS DHE I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT JANAR – DHJETOR 2019**

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt.06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për periudhën Janar-Dhjetor 2019, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2019.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2019 të miratuar, sipas programeve, artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, investimeve të brendshme, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

Për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike buxheti i alokuar për vitin 2019 ishte **49.880 mije lekë** nga të cilat 45.880 mije lekë Shpenzime Korrente dhe 4.000 mije lekë Shpenzime Kapitale me financim të brendëshëm.

Nga zërat më me peshë të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative si dhe projektet e investimeve .

**Shpenzimet totale sipas zërave të buxhetit**

*Në 000/lekë*

<b>Emërtimi i zërave të Buxhetit</b>	<b>Buxheti 2019</b>	<b>Plani I periudhes progresiv</b>	<b>Fakti 8 mujor 2019</b>	<b>Në %</b>
<i>Paga</i>	18.000	16.000	14.367	90%
<i>Sigurime Shoqërore</i>	2.880	2.880	2.308	80%
<i>Mallra dhe Shërbime të Tjera</i>	25.000	25.000	18.065	72%

<i>Trans per Buxh. Fam. &amp; Individ</i>				
<i>Kapitale te brendshme</i>	4.000	4.000	2.993	75%
<i>Financime te huaja total</i>				
<b>TOTALI</b>	<b>49.880</b>	<b>47.880</b>	<b>37.733</b>	<b>79%</b>

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore** (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës, organikës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.45, datë 15.04.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikes së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike”. Shumat e alokuara ne buxhetin vjetor janë përkatësisht 18.000 mijë lekë për artikullin 600 dhe 2.880 mijë lekë për artikullin 601. Gjatë vitit ndodhi një pakësim në artikullin 600 në shumën 2.000 mijë lekë. Shumat e realizuara për periudhën 12 mujore të raportimit janë përkatësisht 14.367 mijë lekë për artikullin 600 dhe 2.308 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në 90% dhe 80% ndaj totalit të alokuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktik të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive.

**Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime** (zëri 602) për periudhën 8 mujore të raportimit, shuma e alokuar ne buxhetin vjetor është përkatësisht 25.000 mijë lekë. Shuma e realizuarar për periudhën 12 mujore të raportimit është 18.065 mijë lekë dhe 72% ndaj totalit të alokuar. Realizimi në këtë masë është i lidhur me situatën e krijuar për shkak të gjendjes të jashtëzakonshme të shpallur për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019, dhe me urdhërin e MFE nr.21920 datë 02.12.2019 nuk lejohej kryerja e pagesave dhe kryerja e prokurimeve të reja përveç atyre që lidheshin me gjendjen e jashtëzakonshme.

**Fondi për Investime të brendshme (zëri 231)**, është miratuar në shumën 4.000 mijë lekë në zërin 231. Nga ky fond për periudhën 12 mujore të raportimit janë realizuar 2.993 mijë lekë. Realizimi i financimit të brendshëm është në masën 75%.

Në vijim paraqiten më të detajuar realizimet e buxhetit për 12 mujorin 2019 sipas programeve përkatëse dhe problematikat gjatë zbatimit të tij:

**Fondi për Investime të brendshme (zërat 231)**, miratuar me buxhetin 2019 ka qenë në shumën 4.000.000 lekë. Sipas pikës 3 të VKM nr.703, datë 29.10.2014 i ndryshuar, si dhe pikës 4 të Udhëzimit nr.2 datë 02.09.2013 “Për standartizimin e termave të referencës për projektet TIK në administratën publike”, ASPA paraqiti kërkesën AKSHI-t për kryerjen e procedurave të blerjes së pajisjeve hardëare TIK me qëllim përmbushjen e misionit dhe realizimin e objektivave të institucionit. Vlera e kërkuar per këtë procedure është 1.761.000 lekë dhe realizimi saj është

1.433 mijë lekë. Nga AKSHI janë lidhur kontrata respektive me përfitues ASPA, me fitues të procedurave të tenderimit të cilat janë likuiduar gjatë muajit shtator dhe gjatë muajit tetor. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese është bere një kërkesë për rialokim ne MF ndërmjet projekteve të investimeve, dhe shuma prej 2.239 mijë lekë e cila ka qënë rialokuar në projektin Rikonstruksion godine (i cili nuk u krye për problem teknike në godinë) kaloi sërish për blerje pajisje IT nga AKSHI. Ky prokurim u krye nga AKSHI dhe u lidhën kontrata respektive me përfitues ASPA të cilat kanë ardhur në institucion në datën 13.12.2019, periudhë në të cilën për shkak të gjendjes të jashtëzakonshme të shpallur për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019 me urdhër të MF nr.21920 datë 02.12.2019 nuk lejohej kryerja e pagesave. Sipas urdhërit tjetër të MF nr 21920/1 datë 20.12.2019 “Faturat e datuara Brenda vitit 2019 do të paraqiten pranë degëve të thesarit Brenda datës 24 dhjetor 2019”, janë marrë në dorëzim materialet dhe janë çuar për likuidim pranë degës së thesarit dy urdhër shpenzimet përkatëse në shumat 1.092.960 lekë dhe 467.280 lekë. Janë pranuar nga dega e Thesarit dhe janë paguar gjatë muajit Janar 2020 me fondet e vitit 2019.

Tabela e Investimeve

Emërtimi i projektit	Buxheti 12-mujor 2019	REALIZIMI 12-mujor 2019	Ne %	Statusi i produktit
1.Blerje pajisje IT	1.761	1.433	81%	Përfunduar
2.Rikonstruksion godine	2.239	0	0%	
3.Blerje pajisje IT	2.239	1.560	70%	Përfunduar